




REPUBLICA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT



Nr. .... Prot.

Vlorë, më 30.06.2017

**Vendim**  
**Nr. 13 datë 30.06.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS SË POZICIONIT "PËRGJEGJËS I GRUPIT MËSIMOR ME KARAKTER MËSIMOR-SHKENCOR" NË UNIVERISTETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Bazuar në vendimin nr. 268, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë të ndryshuar", vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave, pika 17 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", nenin 25/5, 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr 79, datë 12.12.2016 të Senatit Akademik "Për funksionimin e grupeve mësimore, grupeve të përkohshme/të përhershme kërkimore shkencore dhe standardet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor", vendimit nr. 58, datë 31.10.2016 "Për miratimin e grupeve mësimore me karakter kërkimor-shkencor në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Shkencave Humane", vendimit nr. 68, datë 15.11.2016 "Për organizimin e Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë në grupe mësimore me karakter Kërkimor-shkencor", vendimit nr. 82, datë 12.12.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë bazë të Fakultetit të Shëndetit", vendimit nr. 4, datë 13.01.2017 "Për miratimin e grupeve kërkimore shkencore të Departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë", vendimit nr. 15, datë 27.01.2017 "Për miratimin e grupeve me karakter kërkimor-shkencor të Departamentit të ekonomisë në Fakultetin e Ekonomisë", vendimit nr. 57, datë 20.04.2017 "Për krijimin e grupeve me karakter kërkimor shkencor në Departamentin e Matematikës", dhe në dokumentacionin relatues paraqitur nga Administratori i Univeristetit "Ismail Qemali", Vlorë, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.06.2017

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pagën e pozicionit "Përgjegjës i grupit mësimor shkencor" për punonjësit e personelit akademik në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë efektivisht të

Adresa / Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

Web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

Faqe 1 nga 2



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

emëruar në këto pozicione deri në datën 30.06.2017 sipas lidhjes nr. 1 të vendimit nr. 268, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë të ndryshuar"

2. Efektet financiare të këtij vendimi të fillojnë nga data 01.03.2017.
3. Bashkangjitur këtij vendimi vendoset shkresa me nr. 900 Prot, datë 23.06.2017 të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Zyra e financës si dhe Përgjegjësi i Sektorit të administrimit të Burimeve njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Marinela Muço – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar

SEKRETARI:

OLSI VAHEJCI

Ky dokument përpilohet në 4 (katër) kopje.